

PARTNERITETI PËR QEVERISJE TË HAPUR (OGP)

SHËNIMET E MBLEDHJES SE KOMITETIT

24 MARS 2023

MBLEDHJA E KOMITETIT SHUMËPALËSH MBI PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR

Vendi: Kryeministria, Kati tretë

Data: 24.03.2023

Kryesohet: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

Aneks 1: Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve dhe të ftuarëve në Komitet paraqitet në Aneksi I

Aneks 2: Konkluzionet Operacionale paraqitet në Aneksi II

Aneks 3: Dokumenti final i Planit Kombëtar të Veprimit OGP paraqitet në Aneksin 3

I. Hapja e mbledhjes dhe çështjet e diskutuara sipas agjendës/çështjeve për parashtrim:

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, hapi mbledhjen duke falënderuar anëtarët e Komitetit për prezencën e tyre në këtë mbledhje të rëndësishme. Fillimisht u miratua agjenda e takimit, që kishte në fokus diskutimin dhe aprovimin e dokumentit të Planit Kombëtar të Veprimit për OGP.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, parashtoi se dokumenti i Planit Kombëtar të Veprimit për OGP ka përfunduar fazën e fundit të konsultimit publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, përmes konsultimeve në regjistrin elektronik të konsultimit publik, si faza e fundit e procesit të bashkëbërjes së zhvilluar me OSHC-të dhe grupet e interesit.

Koordinatorja Kombëtare theksoi se procesi i zhvilluar ka qenë gjithë-përfshirës dhe në përputhje me standardet dhe metodologjinë e OGP-së. Ajo përmendi zhvillimin e rreth 11 takimeve konsultative tematike me shoqërinë civile, si pjesë e procesit të bashkëbërjes, ku

evidencat përkatëse janë publikuar në faqen www.ogp.al. Në këtë proces kanë kontribuar 12 institucione, të cilat kanë dakordësuar në fund të procesit për paraqitjen e 24 angazhimeve prioritare në 8 fusha/komponentë në kuadër të procesit të bashkë-bërjes, të cilat paraqiten në draftin final të konsultuar edhe sipas procedurës përkatëse në e-konsultimet për një periudhë kohore nga data 6 deri më 23 mars 2023.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve theksoi rëndësinë e miratimit të dokumentit të Planit Kombëtar të Veprimit për OGP, i cili do të raportohet edhe nga Kryeministri në Forumin për Demokraci në që zhvillohet në javën e fundit të marsit Washington D.C, Sh.B.A.

II. Çështjet e diskutuara sipas rendit të ditës

Çështja 1: *Informim mbi procesit e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Komitetit Shumëpalësh*

Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile informoi Komitetin në lidhje me procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të shoqërisë civile në Komitetin e OGP-së:

1. Anëtarët e shoqërisë civile në Komitetin OGP përzgjidhen nga anëtarësia e përfaqësuesve të OSHC-ve në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile,
2. Sipas Ligjit nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” procedura përkatëse për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit është përmbysur brenda shkurtit, por konstituimi i tyre nuk është kryer ende dhe parashikohet të zgjasë deri në muajin maj.
3. U parashtrua ideja dhe u mor vendimi për zhvillimin e një takimi informues mes anëtarëve të vjetër dhe anëtarëve që do të konstituohen dhe do të ulen me pas në Komitet, bashkërenduar nga Sekretariati i Komitetit.
4. U parashtrua nga Ministrja Ekonomi informacioni lidhur me trajnimin për OGP që do të kryhet nga RESPA dhe u diskutua dhënia e mundësisë për anëtarët e rinj për të marrë pjesë në trajnim.

Me qëllim dhënien mundësi të anëtarëve të shoqërisë civile për të qenë pjesë e trajnimit OGP nga RESPA, u mor vendimi në Komitet që trajnimi për OGP-në që do të kryhet nga RESPA, të zhvillohet në muajin maj, pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj të OSHCve në Komitetin OGP.

Cështja. 2: Prezantim i hapave të ndërmarrë në lidhje me procesin e hartimit dhe konsultimit publik të draft-Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur

Ministria e Financave dhe Ekonomise (3 angazhime prioritare)

Zëvendësministri i MFE paraqiti disa ndryshime të vogla, të kërkuara zyrtarisht nga shoqëria civile gjatë fazës finale të konsultimit publik, në angazhimet prioritare finale, të dërguara edhe me email, specifikisht:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore;
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave;
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike.

Këto prioritete lidhen me fushën 4: Transparenca fiskale, për të cilën institucion udhëheqës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Këto prioritete janë miratuar edhe nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur dhe është zhvilluar edhe procesi i bashkë-bërjes. Procesi ka konsistuar në: (i) ***një Anketim/sondazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes***; (ii) ***janë zhvilluan dy takime me shoqërinë civile*** (iii) ***një takim me shoqërinë civile për paketën finale të Plan Veprimit për angazhimet e MFE. Evidencat e procesit janë publikuar në website të OGP.***

Ministria e Arsimit (2 angazhime prioritare)

Përfaqësuesja e MAS pasi diskutoi lidhur me dy angazhimet prioritare të përfshira në dokument, konkretisht:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije,

theksoi se procesi i kryer, në kuadër të bashkë-bërjes me shoqërinë civile, ka konsistuar në (i): Anketim/sondazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes (ii) dy takime me shoqërinë civile. Evidencat e procesit janë publikuar në website të OGP.

Gjithashtu ajo u përgjigj edhe pyetjeve të dërguar paraprakisht nga përfaqësuesi i shoqërisë civile z. Altin Hazizaj.

Anëtarët e Komitetit të Shoqërisë Civile

Anëtarët e shoqërisë civile nuk paraqitën asnjë koment për dokumentin final të qarkulluar ndërkohë që në fillim të marsit. Pozicionimin e tyre në lidhje me dokumentin, anëtarët e Shoqërisë civile e kanë dërguar edhe me email.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve informoi Komitetin, se Rrjeti me pikat fokale për Shoqërinë Civile në cdo ministri linje, si një iniciativë e kërkuar nga anëtarët e Shoqërisë Civile pjesëtarë në Komitetin OGP, është ngritur tashmë. Ky rrjet do t'i shërbejë më së miri transparencës, monitorimit, si edhe procesit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për OGP.

Cështja 3: *Diskutim dhe miratim i draft-Planit dy-vjeçar Kombëtar të Veprimit OGP*

Sekretariati për Komitetin OGP informoi Komitetin për procesin e përmbyllur në mënyrë të sukseshme, ku të gjitha kontributet ishin përfshirë në kohë të shpejtë dhe hapat e procesit ishin zhvilluar sipas Planit të Punës të miratuar në Komitet. Ministrinë e linjës dhe institucionet zhvilluan çdo hap të procesit në përputhje me parimin e bashkë-bërjes me shoqërinë civile, ku evidencat e procesit përkatës janë publikuar në *website* të OGP. Procesi i konsultimit publik përmes e-konsultimeve ishte zhvilluar gjithashtu sipas procedurave përkatëse, si hallka e fundit e procesit të konsultimit. Sugjerimet e dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të përfshihen në dokumentin final.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve paraqiti kërkesën për miratimin e dokumentit të Planit të Veprimit për OGP, pas reflektimit të sugjerimeve të dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin dhe u la kohë deri më 27.03.2023 që Sekretariati të dërgojë draftin final për Kabinetin e MSHSSH, të rakorduar sipas diskutimeve dhe konkluzioneve.

Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, dhe në përputhje me procedurat paketa publikohet nga AKSHI në faqen www.ogp.al

Paketa e aprovimit:

Shënimet e mbledhjes së Komitetit OGP datë 24.03.2023

Agjenda e mbledhjes së Komitetit OGP datë 24.03.2023

Aneks 1: Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve dhe të ftuarëve në Komitet paraqitet në Aneksi I

Aneks 2: Konkluzionet Operacionale paraqitet në Aneksi II

Aneks 3: Dokumenti final i Planit Kombëtar të Veprimit OGP paraqitet në Aneksin 3

Konkluzione:

1. Në përputhje me pika e agjendës, përditësimi i informacionit në lidhje me anëtarët rinj, përfaqësues të Shoqërisë Civile në Komitetin OGP, u krye nga përfaqësuesja e AMSHC, znj. Deasareta Lameborshi. Duke qenë së procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqërisë Civile (përcaktuar me ligjin Nr.119/2015¹), të cilët për zgjedhin edhe anëtarët e Komitetit OGP, është shtyrë deri në maj 2023, u përcaktua dhe miratua që trajnimi për OGPnë që do të kryhet nga RESPA, të zhvillohet në maj, pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj të OSHCve në Komitetin OGP.
2. Rrjeti me pikat fokale për Shoqërinë Civile në cdo ministri linje, si një iniciativë e kërkuar nga anëtarët e Shoqërisë Civile pjesëtarë në Komitetin OGP, është ngritur, sic edhe informuar nga Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve.
3. Procesi i konsultimit publik për draft-Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur nga Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve. Procesi konsistoi në konsultimin e brendshëm ndërinstitucional, të zhvilluar me disa raunde takimesh e diskutimesh, si edhe në konsultimin më aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që konsistoi në disa faza, në përputhje me Planin e Punës të miratuar në Komitetit.
4. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin e Planit dy-vjeçar Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, duke përfshirë edhe disa sugjerime të sjella nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të paraqitura nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë në takimin e Komitetit OGP.
5. Dërgimi i dokumentit final Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur për Zyrat Qëndrore OGP, të do të kryhet datën 27 mars nga Kabineti i Ministrisë së Shtetit për Standardet e Shërbimeve. Kjo datë shënon edhe datën e pranisë së Kryeministrit në Forumin për Demokraci në Washington D.C. Sh.B.A., ku do të raportohet edhe finalizimi i Planit Kombëtar të Veprimit për OGP.
6. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, dhe në përputhje me procedurat paketa publikohet nga AKSHI në faqen www.ogp.al

¹ Ligji Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”